



TREGUESIT SOCIO-EKONOMIKË TË MUNGESËS SË INVESTIMIT NË FONDET E PENSIONIT VULLNETAR NË SHQIPËRI

Abstrakt

Sigurimet shoqërore luajnë një rol të rëndësishëm në nivelin e mirëqenies ekonomike dhe sociale. Njerëzit duan të kenë siguri në situata rreziku. Vështirësitë e hasura në sistemet e sigurimeve shoqërore detyruan shumë vende në të gjithë botën që të vënë në fuqi sistemet vullnetare, të cilat janë sisteme plotësuese ndaj atyre ekzistuese. Një nga këto sisteme është sistemi privat i pensioneve.

Sistemi i pensioneve private që është praktikuar për shumë vite në botë, ka hyrë në fuqi në Shqipëri në vitin 2005, por ende ky treg vijon të paraqesë sfida. Ky studim synon të identifikojë përcaktuesit e mungesës së investimit në fondet vullnetare të pensionit në tregun shqiptar. Për këtë arsye, janë grumbulluar të dhëna parësore nëpërmjet një pyetësoi ballë për ballë në qytetin e Tiranës. Për të testuar rëndësinë e variablave përcaktues në mosinvestim në fondet vullnetare të pensionit, përdoret një model regresioni logjistik, ku si variabël e varur shërben investimi ose jo në fondet e pensionit vullnetar, ndërsa si variabla të pavarur janë testuar në model: mosha, gjinia, arsimimi, niveli i të ardhurave, kursimet, njohja e benefiteve të investimit në këto fonde, marketingu i produktit, mungesa e besimit në sistemin financiar, etj.

Studimi pritet të konkludojë se niveli i ulët i pagave në vendin tonë, mosnjohja e përfitimeve që sjell një investim i tillë, mungesa e besimit dhe mungesa e marketingut të këtij produkti financiar janë disa nga treguesit e nivelit të ulët të investimeve në fondet e pensionit vullnetar.

Forcimi i cilësisë së shërbimit apo promovimi i tyre, si dhe masat e marra për rritjen e nivelit të edukimit financiar dhe besimit në sistemin financiar në vendin tonë janë një strategji e vlefshme për të rritur popullaritetin e skemës.

Fjalë kyçe: fond pensioni vullnetar, investim, edukim financiar, Shqipëri